

## AKT THEMELIMI

### I

#### *Shoqerise Tregtare Me Pergjegjesi Te Kufizuar "CnT Partners" shpk.*

Themeluesit qe firmosin me poshte :

**ERMIR ENGJELLUSH HOXHA** - i datelindjes 08.03.1980 lindur ne Prrenjas dhe banues ne Njesia Administrative nr. 5, Rr. Ndeke Luca, Nd. 4, H. 3, Ap. 7, Tirane, i pajisur me leternjofim me nr. Personal I003082260.

**ERMAL SELMAN TELHA** - i datelindjes 24.09.1986 lindur ne Korce dhe banues ne Njesia Administrative 13, Rr. Selite e vjeter, Kompleksi Fratari, Nd. 1, H.2, Ap.3, Tirane, i pajisur me leternjofim me nr. Personal I60924023P.

Qe ne vijim do te perbeje **Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.**

Sot me date 11.11.2022 bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

### KREU I

#### OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

##### Neni 1


##### Objekti i Shoqerise

Shoqeria ka si objekt, por pa u kufizuar, import-eksport dhe tregtimi i kondicionereve e sistemeve te aspirim kondicionimit, te sistemeve te ngrohjes dhe instalimit te tyre, mirembatjen periodike te sistemeve te ngrohje/ftohje/ventilim/aspirim/kondicionim etj. Import-eksport e tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem. Sherbime ne fushen e ndertimit, projektim, zbatim. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit vetem per nevojat e veta. Import eksport tregtim me shumice dhe pakice elektroshtepiake smart home, smart phone, televizore, kamera vezhgimi, sensor dedektimi, inverter, bateri, artikuj dhe produkte elektrike, projektim, supervizim dhe aplikim i fasadave te ventiluara, strukturale xhami dhe vetrata alumini, konsulence ne fushen e marketingut, negociim ne procesin e shitjes apo blerjes se pasurive te paluajtshme, negociim i kontratave sipermarrese mes paleve te interesuara, konsulence ne fushen fiandciare, juridike, inxhinierike etj. Koordinim i mardhenieve tregtare dhe perfaqesim i te treteve sipas nevojave dhe kontratave te nenshkruara. Mbledhja e debive nga stafi i shoqerise ose permes te treteve, ekspertiza juridike mjedisore, audit te efecences se energjise etj. Investime ne pasuri te paluajtshme, projektme, kolaudime dhe zbatime te projekteve te ndryshme nga stafi i shoqerise ose nepermjet kontratave te sherbimit me te trete. Shoqeria mund te ndermarre aktivitet tregtar, financiar, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet dhe permbushen objektivat e shoqerise. Te kryeje konsulenca mjedisore, Vleresim te ndikimit ne mjedis, auditim mjedisor si dhe hartim te raportit te ndikimit ne mjedis, hartimin e ekspertizave per probleme miedisore, studim, projektim, monitorim mjedisor etj. Hartim dhe implementim i strategjive te ndertimit te brandit ne sektorin e turizmit, bujqesise apo industrise (pa perjashtuar sektoret e tjere te biznesit), plane zhvillimore, studime tregu, anketime, mbledhje te dhenash etj. Promovim i turizmit ne hapesiren kombetare e ate nderkombetare. Sherbime ne fushen e teknologjise se Informacionit (IT), ngritje sistemesh, aplikacionesh, databazash etj. Gjithashtu, shoqeria do te ofroje sherbime qe lidhen me zhvillimin e tregetise, mediave sociale, shendetit publik etj.

##### Neni 2

##### Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket themelues vendosen qe shoqerine ta emertoje "CnT Partners" shpk.





Selia e shoqerise eshte: Njesia Administrative nr. 5, Rr. Ndeke Luca, Nd. 4, H. 3, Ap. 7, Tirane.

Shoqeria mund te krijoje dege, zyra perfaqesimi e filiale brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

### Neni 3

#### Regjimi Juridik

- 1- Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
- 2- Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
- 3- Shoqeria do te kete vulen e saj.

### KREU II

#### TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

### Neni 4

#### Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve.

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ne ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

### Neni 5

#### KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte pa afat te percaktuar.

### KREU III

#### KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

### Neni 6

#### Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 1000000 Leke (nje milion) leke.


### Neni 7


#### Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 2(dy ).

### Neni 8

#### Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar

 22.

 2



Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 500000 leke.

#### Neni 9

#### Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte :

Ortaku **ERMIR HOXHA 50%**

Ortaku **ERMAL TELHA 50%**

#### KREU IV ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 10

Vendimet ne shoqeri merren nga Asambleja e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise, eksperti kontabel i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Pergjithshme

#### KREU V ADMINISTRIMI

#### Neni 11

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti.

#### KREU VI DISPOZITA TE TJERA


#### Neni 12

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakeve te shoqerise sipas pjeseve kontribuese ne kapitalin themeltar.
2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

#### ORTAKET THEMELUES TE Shoqerise "CnT Partners" shpk.

Ortaket

**ERMIR HOXHA**



**ERMAL TELHA**

